

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 Gusht 2010), dhe nenet 57 dhe 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 11/11 Maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2023 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR RAPORTIMIN E BANKAVE

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë afatet, rregullat, format dhe mënyrën e raportimit të bankave në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës-(BQK).
2. Kjo Rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjithë termat e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë siç janë përcaktuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (këtu e tutje: Ligji për Bankat) dhe/ose siç definohe në këtu për qëllime të kësaj rregullore:
 - 1.1. **Certifikata e raportimit** – nënkupton çertifikatën unike të sigurisë e cila mundëson raportimin e bankës në sistemin elektronik, dhe vërteton se të dhënat e institucionit janë të enkriptuara dhe se në momentin që të dhënat importohen në Sistemin Rregullativ të Raportimit të Mbikëqyrjes nga Jashtë (SRrR) banka dhe personat përgjegjës marrin përgjegjësinë se të dhënat janë përfundimtare dhe të raportuara saktë.
 - 1.2. **SRrR** – nënkupton sistemin softuerik për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të raportuara nga institucionet financiare.
 - 1.3. **Udhëzimet për raportim** – nënkuptojnë udhëzimet e aprovuara nga BQK-ja për raportimin e institucioneve financiare në BQK ku janë të specifikuara format e raportimit, udhëzimet e detajuara për plotësimin e formave në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK) dhe rregulloret e BQK-së.
 - 1.4. **XML (Extensible Markup Language)** – nënkupton gjuhën e cila përcakton një set të rregullave të formatit elektronik të raportimit dhe që pranohet si formë e raportimit në SRrR (shih: <http://www.w3.org/XML/>).
 - 1.5. **Kundërkëmbimet e kolateralit** – nënkupton transaksionet e kolateralit kundrejt kolateralit.

1.6. **Viti financiar** – nënkupton periudhën 12 mujore, e cila fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Për një bankë të sapo licencuar, viti financiar fillon nga data e licencimit të saj dhe përfundon më 31 dhjetor të atij viti, ndërsa pas periudhës në fjalë viti financiar duhet të jetë nga 1 janari deri më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 3

Kërkesat e Përgjithshme

1. Çdo bankë, duhet të dorëzojë në BQK raportet të cilat kanë të bëjnë me gjendjen e saj financiare, administrimin dhe operacionet si dhe për të gjitha filialet e saj, qoftë në bazë individuale apo të konsoliduar. Në bazë të kësaj rregulloreje, një bankë e huaj do t'i konsolidojë të dhënat e të gjitha degëve në një raport të vetëm.
2. Raportet përgatiten në format dhe udhëzimet e përcaktuara nga BQK-ja dhe ato mund të ndryshohen kohë pas kohe.
3. Në qoftë se data e raportimit nuk është ditë pune në Kosovë, data e raportimit do të jetë dita e parë e punës.

Neni 4

Raportet e Bankave dhe Afatet e Raportimit

1. Bankat duhet t'i dorëzojnë në BQK jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas fundit të çdo muaji raportet në vijim:
 - 1.1. Faqja e parë (FP);
 - 1.2. Libri kryesor i llogarive (LKLL);
 - 1.3. Bilanci i gjendjes i gjeneruar nga DKLL (BGJ);
 - 1.4. Pasqyra e të ardhurave e gjeneruar nga DKLL (PA);
 - 1.5. Bilanci i gjendjes (F01);
 - 1.6. Pasqyra e të ardhurave (F02);
 - 1.7. Kapitali rregullator (F06);
 - 1.8. Kapitali rregullator (F06-1);
 - 1.9. Peshat e rrezikut për ekspozimet e rrezikut kreditor (F07);
 - 1.10. Klasifikimi i zërave jashtë bilancor (F07-1);
 - 1.11. Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e pozicionit në instrumentet e borxhit të tregtuar (F08);
 - 1.12. Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e pozicionit për instrumentet e kapitalit (F08-1);
 - 1.13. Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e mallrave (F08-2);
 - 1.14. Rreziku i tregut: Qasja e thjeshtë për rrezikun e këmbimit valutor (F08-3);
 - 1.15. Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e shlyerjes / dërgesës (F08-4);

- 1.16. Mjetet e peshuara me rrezik dhe kërkesat e kapitalit për rrezikun operacional (F10);
 - 1.17. Mjetet financiare subjekt i çvlerësimit (F12);
 - 1.18. Rekonsiliimi i provizioneve për humbje nga kreditë dhe ekspozimeve kreditore (F13);
 - 1.19. Raporti për ekspozimet performuese dhe jo-performuese (F14);
 - 1.20. Raporti për kreditë e ristrukturuara (F15);
 - 1.21. Mjetet likuide (F16);
 - 1.22. Depozitat dhe plasmanët në banka (F17);
 - 1.23. Portfolio e Investimeve (F18);
 - 1.24. Ekspozimet e mëdha (F19);
 - 1.25. Personat e ndërlidhur me bankën (F20);
 - 1.26. Depozitorët më të mëdhenj (F21);
 - 1.27. Depozitat dhe plasmanët nga institucionet financiare (F22);
 - 1.28. Llogaritja e rezervës së likuiditetit (F23);
 - 1.29. Mirëmbajtja e rezervës së likuiditetit (F24);
 - 1.30. Pozicionet në valutë të huaj (F26);
 - 1.31. Mjetet Likuide - TML1 (31);
 - 1.32. Rrjedhat Dalëse (31-1);
 - 1.33. Rrjedhat Hyrëse (31-2);
 - 1.34. Kundërkëmbimet e Kolateralit (31-3);
 - 1.35. Llogaritjet (31-4);
 - 1.36. Rrjedhat Dalëse Shtesë për Produktet dhe Shërbimet Tjera (31-5).
2. Bankat duhet t'i dorëzojnë në BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas fundit të çdo tremujori, përveç raporteve të specifikuara në paragrafin 1 të këtij neni edhe raportet si në vijim:
- 2.1. Treguesin e leverazhit (F09);
 - 2.2. Kreditë dhe paradhëniet sipas aktivitetit ekonomik, kreditë e klasifikuara dhe të ristrukturuara (F11);
 - 2.3. Hendeku i likuiditetit (F25);
 - 2.4. Raporti mbi kreditë hipotekare rezidenciale dhe kreditë hipotekare komerciale (F27);
 - 2.5. Rreziku i normës së interesit në librin e bankës (F28);
 - 2.6. Kolateralet dhe garancionet e pranuar (F29);
 - 2.7. Provizionet dhe detyrimet kontigjente (F30);

¹ Treguesi i mbulimit me likuiditet.

- 2.8. Financimi i Qëndrueshëm i Kërkuar (RSF)² (32);
 - 2.9. Financimi i Qëndrueshëm në Dispozicion (32-1);
 - 2.10. Përmbledhje NSFR³ (32-2).
3. Bankat duhet t'i dorëzojnë në BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas fundit të çdo gjashtëmujori, përveç raporteve të specifikuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni edhe raportet si në vijim:
 - 3.1. Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave (F03);
 - 3.2. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet (F04);
 - 3.3. Pasqyra e rrjedhës së parasë (F05).

Neni 5

Raportimi i konsoliduar

1. Bankat të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar sipas rregullores për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve bankare duhet t'i dorëzojnë në BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas fundit të çdo muaji raportet si në vijim:
 - 1.1. Mjetet Likuide - TML⁴ (31);
 - 1.2. Rrjedhat Dalëse (31-1);
 - 1.3. Rrjedhat Hyrëse (31-2);
 - 1.4. Kundërkëmbimet e Kolateralit (31-3);
 - 1.5. Llogaritjet (31-4);
 - 1.6. Rrjedhat Dalëse Shtesë Për Produktet Dhe Shërbimet Tjera (31-5).
2. Bankat të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar sipas rregullores për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve bankare duhet t'i dorëzojnë në BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas fundit të çdo tremujori raportet si në vijim:
 - 2.1. Faqja e parë (FP);
 - 2.2. Ditari kryesor i llogarive (DKLL);
 - 2.3. Bilanci i gjendjes i gjeneruar nga DKLL (BGJ);
 - 2.4. Pasqyra e të ardhurave e gjeneruar nga DKLL (PA);
 - 2.5. Bilanci i gjendjes (F01);
 - 2.6. Pasqyra e të ardhurave (F02);
 - 2.7. Kapitali rregullator (F06);
 - 2.8. Kapitali rregullator (F06-1);
 - 2.9. Peshat e rrezikut për ekspozimet e rrezikut kreditor (F07);

² Shuma e financimit të qëndrueshëm të kërkuar (anglisht: Amount of Required Stable Funding).

³ Treguesi i financimit të qëndrueshëm neto (anglisht: Net Stable Funding Ratio).

⁴ Treguesi i mbulimit me likuiditet.

- 2.10. Klasifikimi i zërave jashtë bilancor (F07-1);
 - 2.11. Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e pozicionit në instrumentet e borxhit të tregtuar (F08);
 - 2.12. Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e pozicionit për instrumentet e kapitalit (F08-1);
 - 2.13. Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e mallrave (F08-2);
 - 2.14. Rreziku i tregut: Qasja e thjeshtë për rrezikun e këmbimit valutor (F08-3);
 - 2.15. Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e shlyerjes / dërgesës (F08-4);
 - 2.16. Treguesin e leverazhit (F09);
 - 2.17. Mjetet e peshuara me rrezik dhe kërkesat e kapitalit për rrezikun operacional (F10);
 - 2.18. Kreditë dhe paradhëniet sipas aktivitetit ekonomik, kreditë e klasifikuara dhe të ristrukturuara (F11);
 - 2.19. Mjetet financiare subjekt i çvlerësimit (F12);
 - 2.20. Rekonsiliumi i provizioneve për humbje nga kreditë dhe ekspozimeve kreditore (F13);
 - 2.21. Raporti për ekspozimet performuese dhe jo-performuese (F14);
 - 2.22. Raporti për kreditë e ristrukturuara (F15);
 - 2.23. Mjetet likuide (F16);
 - 2.24. Ekspozimet e mëdha (F19);
 - 2.25. Personat e ndërlidhur me bankën (F20);
 - 2.26. Pozicionet në valutë të huaj (F26);
 - 2.27. Kolateralet dhe garancionet e pranuar (F29);
 - 2.28. Financimi i Qëndrueshëm i Kërkuar (RSF)⁵ (32);
 - 2.29. Financimi i Qëndrueshëm në Dispozicion (32-1);
 - 2.30. Përmbledhje NSFR (32-2).
3. Bankat të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar sipas Rregullores së BQK-së për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve bankare duhet t'i dorëzojnë në BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas fundit të çdo gjashtëmujori të vitit financiar, përveç raporteve të specifikuara në pikën 1 të këtij neni edhe raportet si në vijim:
 - 3.1. Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave (F03);
 - 3.2. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet (F04);
 - 3.3. Pasqyra e rrjedhës së parasë (F05).

⁵ Shuma e financimit të qëndrueshëm të kërkuar (ang. amount of required stable funding)

Neni 6

Raportimi i Degëve të Bankave të Huaja për Bankat Mëmë

1. Degët e bankave të huaja përveç raporteve të kërkuara sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje lidhur me aktivitetin e tyre në Kosovë, gjithashtu duhet t'i dorëzojnë në BQK, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike pas fundit të çdo tremujori raportet financiare të bankës mëmë, si në vijim:
 - 1.1. Raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit;
 - 1.2. Kapitalin rregullator (fondet e veta)
 - 1.3. Treguesin e kredive me probleme ndaj gjithsej kredive
 - 1.4. Treguesin e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive
 - 1.5. Treguesin e kredive me probleme neto ndaj kapitalit rregullator (fondet e veta);
 - 1.6. Treguesin e shumës së rezervave për humbjet nga kreditë ndaj gjithsej kredive joperformuese
 - 1.7. Treguesi i kthimit në mjete mesatare (ROAA)
 - 1.8. Treguesi i kthimit në ekuitet (ROAE)
 - 1.9. Treguesi i mjeteve likuide ndaj gjithsej mjeteve;
 - 1.10. Treguesi i mjeteve likuide afatshkurtra ndaj detyrimeve afatshkurtra – deri në tre muaj.

Neni 7

Raporti Vjetor

1. Bankat më së voni brenda 4 muajve pas përfundimit të vitit financiar duhet t'i dorëzojnë BQK-së raportin vjetor, së bashku me mendimin e auditorit të jashtëm dhe letrën e menaxhmentit për vitin e kaluar financiar.
2. Bankat pas raportit të auditorit të jashtëm duhet të ri dorëzojnë raportet e përcaktuara në nenin 4 dhe 5 të kësaj rregullore në pajtim me afatet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Degët e bankave të huaja, përveç obligimit në paragrafin 1 të këtij neni, duhet t'i dorëzojnë BQK-së raportin vjetor të konsoliduar të bankës mëmë së bashku me mendimin e auditorit të jashtëm, më së voni brenda 4 javësh nga lëshimi i tyre.
4. BQK në rastet kur e vlerëson të nevojshme, mund të kërkoj nga filialet e bankave të huaja të dorëzojnë raportin vjetor të konsoliduar të bankës mëmë, së bashku me mendimin e auditorit të jashtëm.

Neni 8

Raportimi Shtesë

BQK mund të kërkoj, sipas nevojës dhe rastit, që të raportohet më shpesh, më gjerësisht ose të kërkoj raporte të tjera kur konsiderohet e nevojshme, me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë mbikëqyrëse.

Neni 9

Detyrimet dhe mënyra e raportimit të bankave

1. Bankat duhet të dorëzojnë raportet në afatet dhe në formën e përcaktuar nga BQK-ja, në përputhje me udhëzimet e aprovuara nga BQK-ja për raportim në sistemin SRrR.
2. Raportimi nga bankat sipas kësaj rregulloreje duhet të bëhet në formë elektronike në sistemin e raportimit SRrR në formatin XML, duke përdorur certifikatën e raportimit të përcaktuar nga BQK-ja.
3. Shkresa përcjellëse në formë fizike (sipas aneksit 1) për raportet e dërguara në formë elektronike sipas paragrafit 2 të këtij neni duhet të dorëzohet në BQK e vulosur dhe e nënshkruar nga kryeshefi ekzekutiv, zyrtari kryesor i financave dhe nga personi përgjegjës për raportim në sistem.

Neni 10

Përgjegjësia për saktësinë e raportimit

1. Bankat marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar saktësinë e të dhënave të raportuara dhe janë përgjegjëse për saktësinë e tyre, në përputhje me nenin 9 të kësaj rregullore.
2. Personat e drejtpërdrejtë përgjegjës për sigurimin e saktësisë së raportimit në pajtim me nenin 9 të kësaj rregullore janë kryeshefi ekzekutiv dhe zyrtari kryesor i financave.
3. Nëse banka identifikon se ekziston ndonjë pasaktësi në të dhënat e raportuara pas dërgimit të tyre në BQK, ajo duhet të njoftoj menjëherë BQK-në lidhur me këto pasaktësi.
4. Nëse BQK konstaton se të dhënat e raportuara janë të pasakta, do të urdhërojë korrigjimin e tyre nga bankat raportuese si dhe përsëritjen e raportimit pas korrigjimeve. Urdhëresa për korrigjimin e raportimit sipas këtij paragrafi, nuk e përjashton mundësinë e marrjes së masave përmirësuese në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Në zbatim të paragrafit 3 të këtij neni bankat duhet të kryejnë korrigjimet përkatëse dhe i raportojnë ato brenda ditës pasardhëse të punës, në përputhje me nenin 9 të kësaj rregullore.

Neni 11

Dispozitat Përfundimtare

Në zbatim të kësaj Rregulloreje BQK do të nxjerrë udhëzime dhe formularë që përcaktojnë mënyrën dhe formën e raportimit.

Neni 12

Zbatimi, Masat Përmirësuese dhe Dënimet Civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për banka.

Neni 13
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Raportimin e Bankave e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës me 26 mars 2020 dhe çdo dispozitë tjetër që mund të jetë në kundërshtim me këtë Rregullore.

Neni 14
Shtojca

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është Aneksi 1.

Neni 15
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Bashkim Nurboja
Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Aneksi 1

Shkresa përcjellëse në formë fizike



Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare Shkresa përcjellëse

Emri i institucionit:

Kodi i institucionit:

Adresa:

Lloji i institucionit:

Periudha e raportimit:

Forma (frekuenca) e raportimit:

Data e raportimit:

I audituar:

Data dhe ora e ngarkimit të raportimit:

Emërimi i raportit:

Formularët e raportimit:

Kodi	Emri i formularit	√
SGL	Ditari kryesor i llogarive - DKLL	
BS	Bilanci i gjendjes i gjenruar nga SGL	
IS	Pasqyra e të ardhurave e gjeneruar nga SGL	
F01	Bilanci i gjendjes	
F02	Pasqyra e të ardhurave	
F03	Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave	
F04	Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	
F05	Pasqyra e rrjedhës së parasë	
F06	Raporti i kapitalit rregullator	
F06-1	Kapitali rregullator	
F07	Peshat e rrezikut për ekspozimet e rrezikut kreditor	
F07-1	Klasifikimi i zërave jashtë bilancor	
F08	Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e pozicionit në instrumentet e borxhit të tregtuar	

F08-1	Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e pozicionit për instrumentet e kapitalit	
F08-2	Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e mallrave	
F08-3	Rreziku i tregut: Qasja e thjeshtë për rrezikun e këmbimit valutor	
F08-4	Rreziku i tregut: Qasja e standardizuar për rrezikun e shlyerjes / dërgesës Treguesin e leverazhit	
F09	Treguesin e leverazhit	
F10	Mjetet e peshuara me rrezik dhe kërkesat e kapitalit për rrezikun operacional	
F11	Kreditë dhe paradhëniet sipas aktivitetit ekonomik, kreditë e klasifikuara dhe të ristrukturuara	
F12	Mjetet financiare subjekt i çvlerësimit	
F13	Rekonsiliimi i provizioneve për humbje nga kreditë dhe ekspozimeve kreditore	
F14	Raporti për ekspozimet performuese dhe jo-performuese	
F15	Raporti për kreditë e ristrukturuara	
F16	Mjetet likuide	
F17	Depozitat dhe plasmanët në banka	
F18	Portfolio e Investimeve	
F19	Ekspozimet e mëdha	
F20	Personat e ndërlidhur me bankën	
F21	Depozitorët më të mëdhenj	
F22	Depozitat dhe plasmanët nga institucionet financiare	
F23	Llogaritja e rezervës së likuiditetit	
F24	Mirëmbajtja e rezervës së likuiditetit	
F25	Hendeku i likuiditetit	
F26	Pozicionet në valutë të huaj	
F27	Raporti mbi kreditë hipotekare rezidenciale dhe kreditë hipotekare komerciale	
F28	Rreziku i normës së interesit në librin e bankës	
F29	Kolateralet dhe garancionet e pranuar	
F30	Provizionet dhe detyrimet kontigjente	
F31	Mjetet Likuide (TML)	
F31-1	Rrjedhat Dalëse	
F31-2	Rrjedhat Hyrëse	
F31-3	Kundërkëmbimet e Kolateralit	
F31-4	Llogaritjet	
F31-5	Rrjedhat Dalëse Shtesë Për Produktet Dhe Shërbimet Tjera	
F32	Financimi i Qëndrueshëm i Kërkuar (RSF)	
F32-1	Financimi i Qëndrueshëm në Dispozicion	
F32-2	Përmbledhje NSFR	

Deklarata e zyrtarit përgjegjës për raportim, Kryeshefi ekzekutiv, Zyrtari kryesor i financave dhe Personi përgjegjës për raportim:

Përmes kësaj shkrese deklarojmë se raportet e ngarkuara në sistemit ORRS janë përgatitur në përputhje me kërkesat e BQK-së dhe udhëzimet për raportim. Raportet saktë reflektojnë kushtet e bankës deri me datën e Raportimit. Është e kuptueshme se çdo paraqitje e jo e drejtë me qëllim në këtë raport mund të rezultojë me sanksione komfor legjisacionit në fuqi që do të zbatohen kundër Kryeshefi ekzekutiv, Zyrtarit kryesor të financave dhe Personit përgjegjës për raportim si dhe / ose bankës që raporton.

Kryeshefi ekzekutiv:

(nënshkrimi)

Personi përgjegjës për raportim

(nënshkrimi)

Zyrtari kryesor i financave:

(nënshkrimi)